

LIGJ
Nr. 68/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
SË HUAS DHE PROGRAMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E
PROGRAMIT “FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe e programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10917, datë 19.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Faks: (+355) 4 222 8494

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Samë Frasheri”, nr. 10
Tiranë, Shqipëri

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me
Shqipërinë

Dokument ndryshues i Marrëveshjes së
Huas dhe i Programit ndërmjet KfW
Frankfurt am Main, Republikës së
Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e
Financave dhe Fondit Shqiptar të
Zhvillimit, për financimin e “Fondit të
investimeve sociale IV”

Marrëveshja e Huas dhe e programit
Datë 23 dhjetor 2010
Vlera : 20 milionë euro
BMZ nr. 2010 65 721
Nr. i llogarisë së Huas: 24916

Datë 30 prill 2018

Banka e Zhvillimit KfW

Eva Niepagenkemper

Referenca jonë: NgE

Nr. tel.: +49 69 7431 - 7655

Faks: +49 69 7431-2944

Eva.Niepagenkemper@kfw.de

Siç është ndryshuar herë pas here (**Marrëveshja e Huas dhe e Programit**).

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas dhe të Programit dhe shkresave tuaja, ne datat 15 dhjetor 2017 dhe 26 mars 2018, ku kërkon zbatim të afatit të disbursimit dhe përshtatje të emërimit dhe adresës së Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë, me anë të kësaj shkrese, se mund ta plotësojmë kërkesën tuaj për zbatim të afatit të disbursimit deri më 30 tetor 2018. KfW, për të mundësuar përmbylljen e suksesshme të projektit në fjalë, do të marrë përsipër, vetëm për këtë rast, kostot shtesë të rifinancimit të shkaktuara nga shtyrja e afatit të disbursimit.

Rrjedhimisht, ne biem dakord për modifikimet e mëposhtme në Marrëveshjen e Huas dhe të Programit:

Seksioni A. Modifikime të Marrëveshjes së Huas dhe të Programit

Marrëveshja e Huas dhe e Programit do të modifikohet si më poshtë:

1. Sa herë që në të gjithë tekstin e Marrëveshjes së Huas dhe të Programit përmendet emërtimi “Ministria e Financave”, të fshihet dhe të zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

2. Neni 3.2, “Afati për kërkimin e disbursimit” të hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

“KfW mund të refuzojë disbursimin pas datës 30 tetor 2018.”.

3. Në nenin 13.2, “Adresa e Huamarrësit për dërgimin e njoftimeve” të hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

“Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faks: (+355) 4 222 8494”

Seksioni B. Dispozita shtesë

1. Kjo shkresë nuk ndryshon apo tërheq dispozita të Marrëveshjes së Huas dhe të Programit, përveç nëse përcaktohet shprehimisht në këtë shkresë.

2. Dispozitat e nenit 10 (*Kostot dhe pagesat publike*), nenit 11.5 (*Pajtuëshmëria*), nenit 13.2 (*Adresa*), nenit 14.3 (*Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet*), nenit 14.4 (*Forma e shkrimit*), nenit 14.6 (*Ligji i zbatueshëm*) dhe nenit 14.9 (*Mosmarrëveshjet ligjore*) të Marrëveshjes së Huas dhe të Programit, të datës 23 dhjetor 2010, të përfshihen në këtë shkresë, sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë shkresë dhe, sikur referencat në këto pika të Marrëveshjes të ishin referenca për këtë shkresë.

Ju lutem konfirmoni pëlqimin tuaj për ndryshimet e përmendura më sipër, duke nënshkruar në një formë të detyrueshme ligjore dhe duke i dërguar KfW-së kopjen origjinale.

Përgatitur në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Me respekt,

KfW

Dr. Kirk Mildner
Drejtnes Divizioni
Banka e Zhvillimit KfW

Christina Kern
Menaxhere Projekti
Banka e Zhvillimit KfW

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, 24.7.2018

Tiranë, _____ 2018

Për dhe në emër të
Republikës së Shqipërisë

Për dhe në emër të Fondit
Shqiptar të Zhvillimit

Emri:
Titulli:

Emri:
Titulli: